



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:025372

Datë: 15.04.2021

Numri i dokumentit: 01693617

**PKR.nr.62/21**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA**, me kryetarin e trupit gjykues Shaqë Curri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fitore Bojku, në çështjen penale kundër të pandehurve F. R. dhe F. O., për shkak se si bashkëkryes kanë kryer veprën penale të grabitjes, nga neni 317 par.3, lidhur me par.1 dhe nenin 31, të KPRK-së dhe të pandehurit O. H., për shkak të veprës penale dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprës penale nga neni 380 par.1, të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.57/21, të dt. 16.03.2021, mbajti seancën publike të shqyrtimit fillestar, me dt.02.04.2021, në prezencë të Prokurores së shtetit Valbona Disha Haxhosaj, të pandehurit F. R., mbrojtësit të tij av. A. M., sipas autorizimit, të pandehurit F. O., mbrojtësit të tij av. G. B., i caktuar sipas detyrës zyrtare, të pandehurit O. H., mbrojtësit të tij av. H. M., i caktuar sipas detyrës zyrtare dhe të dëmtuarit B. D., në të njëjtën ditë mori dhe shpalli publikisht, ndërsa me dt.15.04.2021, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Ndaj të pandehurve**

**F. R.**, i biri i H. dhe nënës H. i gjinisë B., i lindur me dt. .... ne ....., ndërsa tani me vendbanim në rr “.....”, nr.8 - Pejë, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, me profesion kuzhinier, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër personal ....., ka të kaluar kriminale (recidivist), shqiptar shtetas i R. se Kosovës, gjendet në paraburgim nga data 09.02.2021

**F. O.**, i biri i R., dhe nënës H., i gjinisë A., i lindur me dt..... ne ....., ndërsa me vendbanim në fsh..... K-....., i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, me profesion gurgdhendës, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër personal ....., ka të kaluar kriminale (recidivist), shqiptar shtetas i R. se Kosovës, gjendet në paraburgim nga data 09.02.2021.

**O. H.**, i biri i A. dhe nënës M. i gjinisë F., i lindur me dt..... në ....., ndërsa me vendbanim në rr.”.....”, nr.26, K-Pejë, i pa martuar, i gjendjes se dobët ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër personal ....., i pa punë, ka te kaluar kriminale (recidivist) shqiptar shtetas i R. se Kosovës, ka qenë ne paraburgim nga data 09.02.2021 e deri me dt. 02.04.2021, tani mbrohet në liri

## **PËR SHKAK SE:**

### **Të pandehurit F. R. dhe F. O.**

Më dt. 08.01.2021 rreth orës 01:00 në fsh. .... K. ...., e pikërisht në subjektin afaristë, pompën e benzinës “ ....., me qëllim të përvetësimit të pasurisë se luajtshme për vete, të pandehurit duke vepruar si bashkë kryes dhe me armë e kanë sulmuar të dëmtuarin B. D. nga fsh. .... K. ...., në atë mënyrë që të pandehurit duke vepruar sipas propozimit të pandehurit Sh. (i cili gjendet në arrati), nga ..... kanë shkuar në drejtim të fsh. ....K. .... me automjetin e tipit ..... me ngjyrë hiri, me numër të targave ..... automjet i marr me qira nga i pandehuri Sh. në Renta Car ..... me seli në ....., të njëjtit pasi që e parkojnë automjetin 500 m larg nga vendi i ngjarjes në rrugën ..... -..... buzë rrugës, shkojnë në këmbë duke kaluar nëpër disa ara të vendi i ngjarjes, dhe në momentin kur ndërpritet rryma në pompë dhe në objektet përreth, i dëmtuari i cili ishte vetëm në krye të detyrës shkon prapa pompës për ta aktivizuar gjeneratorin, me ç’ rast gjersa i pandehuri F. bënë roje, i pandehuri Sh. i afrohet viktimës dhe me përdorimin e forcës dhe armës e venë nën kontroll viktimën, kurse i pandehuri F. i afrohet viktimës dhe nga xhepi i pantallonave të viktimës i grabit 150 euro dhe një telefon Samsung, kurse nga brendia e objektit të pompës i pandehuri F. i merr para në shumë prej 960 euro, më pas largohen nga vendi i ngjarjes duke shkuar të shtëpia e të pandehurit O., ku të pandehurit Sh., F. dhe F. i ndajnë parat e grabitura në mes vete.

- me çka si bashkëkryes kanë kryer veprë penale, të grabitjes nga neni 317 par. 3 lidhur me par. 1 dhe nenin 31 të KPK-së.

### **I Pandehuri O. H.**

Më dt.08.01.2021 rreth orës 01:00 në ....., i ka strehuar dhe ju ka ndihmuar të pandehurve Sh. A., F. R. dhe F. O., nga shmangia zbulimit të veprës penale të grabitjes, në atë mënyrë që ditën kritike pasi të pandehurit e lartcekur kryejnë veprën penale të grabitjes si në dipsozitivin e parë të kësaj akuze, i pandehuri O. pasi që fillimisht i strehon kryesit pas kryerjes së veprës penale në shtëpinë e tij, i njëjti nuk i lajmëron organet e hetuesisë për kryesit e veprës penale të grabitjes në dëm të dëmtuarit B. D..

- me çka ka kryer veprë penale dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprës penale nga neni 380 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 7, 21, 31, 38, 40, 42, 43, 69, 70, 71, 72, të KPRK-së, nenit 317 par.3, lidhur me par. 1 dhe nenin 31, te KPRK-së, nenit 380 par.1, të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, të pandehurit:

## **I G J Y K O N**

### **Të pandehurin F. R.**

**Dënim me gjobë, në shumë prej 1000 (njëmijë) euro**, të cilën dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguajë në afat prej 30 ditësh, pasi që aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm, dhe

**Dënim me burg në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite**, e në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt. 09.02.2021 e tutje, këtë dënim i pandehuri do ta mbajë pasi që aktgjykimi do të bëhet i plotfuqishëm.

Nëse i pandehuri i lartcekur dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimin me gjobë gjykata do ta zëvendësojë me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës.

### **Të pandehurin F. O.**

**Dënim me gjobë, në shumë prej 1000 (njëmijë) euro**, të cilën dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguajë në afat prej 30 ditësh, pasi që aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm, dhe

**Dënim me burg në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite**, e në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt. 09.02.2021 e tutje, këtë dënim i pandehuri do ta mbajë pasi që aktgjykimi do të bëhet i plotfuqishëm.

Nëse i pandehuri i lartcekur dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimin me gjobë gjykata do ta zëvendësojë me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës.

### **Të pandehurin O. H.**

**Dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashhtë) muaj**, e në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt. 09.02.2021 e deri me dt.02.04.2021, këtë dënim i pandehuri do ta mbajë pasi që aktgjykimi do të bëhet i plotfuqishëm.

Të pandehurit secili veç e veç obligohen që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumë të vogla prej 50 (pesëdhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit,

Të pandehurit secili veç e veç obligohen që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari B. D., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngrit aktakuzë PP/I.nr. 57/21, të dt. 16.03.2021, kundër të pandehurve F. R. dhe F. O., për shkak të veprës penale të

grabitjes te kryer në bashkëkryerje , nga neni 317 par.3, lidhur me par.1 dhe nenin 31, të KPRK-së dhe të pandehurit O. H., për shkak të veprës penale dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprës penale nga neni 380 par.1, të KPRK-së.

Konform nenit 245 të KPP-së me dt. 02.04.2021, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar dhe të pranishëm kanë qenë prokurori i shtetit Valbona Disha Haxhosaj, i pandehuri F. R., mbrojtësi i tij av. A. M., sipas autorizimit, i pandehuri F. O., mbrojtësi i tij av. G. B., i caktuar sipas detyrës zyrtare, i pandehuri O. H., mbrojtësi i tij av. H. M., i caktuar sipas detyrës zyrtare dhe i dëmtuari B. D..

Gjykata konform dispozitave te nenit 246 par. 1, të KPP-së, i ka udhëzuar të pandehurit secilin veç e veç me të drejtat e tyre, ku në këtë rast i pandehuri F. R., është deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij dhe se për mbrojtës e ka shfrytëzuar këtë të drejtë, ka angazhuar av. A. M., sipas përzgjedhjes së tij. I pandehuri F. O., është deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij dhe se për mbrojtës, e ka pranuar avokatin e caktuar sipas detyrës zyrtare. I pandehuri O. H., është deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij dhe se për mbrojtës, e ka pranuar avokatin e caktuar sipas detyrës zyrtare

Pas leximit të aktakuzës nga prokurorja e shtetit, kryetari i trupit gjykues, pasi që është bindur se të pandehurit e kanë kuptuar aktakuzën, ju ka dhënë mundësi të pandehurve që të deklarohen për pranimin, ose mospranimin e fajësisë, duke i njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

I pandehuri F. R., ka deklaruar se e kam pranuar fajësinë nga fillimi i kësaj procedure penale në të gjitha fazat, të njëjtin pranim e bëj edhe sot me vullnet të plotë, i vetëdijshëm se çka jam duke pranuar, i kërkoj falje gjykatës të gjitha palëve në procedurë familjes sime si të dëmtuarit B. D., premtoj se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale.

I pandehuri F. O., ka deklaruar se e pranoj fajësinë për veprën penale e cila më vihet në barrë, ndihem i penduar, ju kërkoj falje gjykatës të dëmtuarit dhe premtoj më se nuk do të përsëris vepra tjera penale.

I pandehuri O. H., ka deklaruar se e pranoj fajësinë për veprën penale e cila më vihet në barrë, ndihem i penduar, i kërkoj falje të dëmtuarit, i premtoj gjykatës se nuk do të përsëris vepra tjera penale.

Prokurorja e shtetit Valbona Disha Haxhosaj, ka deklaruar se meqenëse të akuzuarit secili veç e veç e pranuan fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohen dhe meqenëse një pranim është bazuar edhe në provat materiale në bazë të cilave është ngritur aktakuza, i ka propozuar gjykatës që ta aprovojë pranimin e fajësisë për të tre të akuzuarit.

I dëmtuari B. D., ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana të pandehurve poashtu kërkon dëmshpërblim nga kryesit e veprave penale.

Mbrojtësi i të pandehurit F. R., av. A. M., ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit te tij, i njëjti e ka pranuar fajësinë që në fazat fillestare të kësaj procedure penale e gjithashtu ky pranim ka mbështetje në të gjitha shkresat e lëndës, në bazë të cilave

është ngritur aktakuza, e lut gjykatën që ta aprovojë pranimin e fajësisë, pranimi i fajësisë është institut i cili vetvetiu i krijon lehtësi si gjykatës poashtu edhe vet të të akuzuarit. Megjithatë kur kemi të bëjmë me matjen e dënimit duhet tenmerr si rrethanë veçanërisht lehtësuese faktin se roli i të mbrojturit tim në kryerjen e kësaj veprë penale ka përgjegjësi shumë të vogël. E lut gjykatën q te ketë parasysh edhe gjendjen e dobët ekonomike shprehjen e keqardhjes dhe pendimin e thellë të të mbrojturit të tij. Po ashtu gjykata të ketë parasysh edhe faktin se i mbrojturi ti tij është është përdorues i narkotikut. Në bazë të të gjitha këtyre i ka propozuar gjykatës qe te mbrojturi te tij ti shqiptohet dënim nën minimumin e paraparë me ligj, e gjithashtu ka kërkuar nga gjykata ndërprerjen e paraburgimit pasi që tani kanë pushuar të gjitha arsyet për të cilat është caktuar paraburgimi, e poashtu familja e të mbrojturit te tij, kanë shprehur gatishmëri për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga i mbrojturi im.

Mbrojtësi i të pandehurit F. O., av. G. B., ka deklaruar se meqenëse i mbrojturi i tij prej fillimit të procedurës penale ka pranuar fajësinë të njëjtin pranim e bëri edhe sot, ka propozuar që të aprovohet pranimi i fajësisë, meqenëse i mbrojturi i tij është në paraburgim, mendon se nuk ka arsye që i njëjti të mbahet në paraburgim, ka propozuar që të njëjtit ti ndërpritet paraburgimi deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit. Sa i përket rrethanave lehtësuese mendon që gjykata sipas detyrës zyrtare do ti vlerësojë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe do ti shqiptojë dënim i cili do të arrinte qëllimin e dënimit. Dëmi në këtë veprë penale nuk ka qenë i madh dhe kjo ti vlerësohet si rrethanë lehtësuese.

Mbrojtësi i të pandehurit O. H., av. H. M., ka deklaruar se e mbështes pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit te tij, ky pranim është rezultat i konsultimeve paraprake me të andaj kërkon nga gjykata pas pranimit të fajësisë, pendimit të tij të thellë në të gjitha fazat e procedurës, ti ketë parasysh këto si rrethana lehtësuese me rastin e shqiptimit të një dënimi sa më të butë. Meqenëse i mbrojturi i tij akuzohet për një veprë më të lehtë penale propozoj që të mbrojturit te tij ti ndërpritet paraburgimi meqenëse kanë pushuar kushtet ligjore për të cilat i është caktuar paraburgimi.

Prokurorja e shtetit pas deklarimeve të mbrojtësve për pranimin e fajësisë nga ana të pandehurve, ka shtuar se meqenëse mbrojtësit u deklaruan lidhur me rrethanat lehtësuese siç ishin ato pranimi i fajësisë, pendimi për veprën e kryer, kushtet ekonomike, kërkim falja, premtimin se nuk do të përsërisin më vepra penale, i propozoj gjykatës si rrethana rënduese përveç lehtësuese ti vlerësojë edhe ato. Frikën e shkaktuar tek i dëmtuari, si dhe të kaluarën kriminale të secilit të akuzuar veç e veç ku i akuzuari F. R., është shpallur fajtor me aktgjykimin e gjykatës themelore në Pejë. PKR. nr.10/20, dt. tt. 09.02.2020, për veprë penale nga neni 267 par.1, lidhur me nenin 35 dhe nenin 77 të KPRK-së, poashtu i akuzuari F. R., është shpallur fajtor edhe me aktgjykimin e gjykatës themelore në Pejë P.nr. 197/18, të dt. 24.05.2018, për veprë penale nga neni 374 par.1, të KPRK-së. I akuzuari O. H. është shpallur fajtor me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë P.nr. 827/18, të dt. 20.07.2020, për veprë penale nga neni 188 par.1, nënpar.1.4, të KPRK-së. Për të akuzuarin F. O. si rrethanë rënduese të merret parasysh aktgjykimi i gjykatës komunale në Pejë P.nr.27/09, dhe P.nr.108/09, dt. 23.03.2009, ku i njëjti është dënuar për veprë penale të shpërdorimit nga neni 257 par.1, të KPK-së, si dhe aktgjykimi i gjykatës së Qarkut në Pejë , P.nr. 235/10, dt. 28.03.2011, ku i akuzuari F. është dënuar për veprë penale nga neni 328 par.2, të KPK-së, ku si provë ju dorëzoj kopjet e aktgjykimit që do të jenë pjesë përbërëse të lëndës.

Mbrojtësit dhe të pandehurit kanë refuzuar që të mirën si provë aktgjykimet të dorëzuara nga prokuroria në këtë shqyrtim. Mirëpo gjykata ka vlerësuar se këto aktgjykime te qëndrojnë ne shkresa te lënde pasi qe këto aktgjykime, vetëm dëshmojnë te kaluarën kriminale te

pandehurve dhe prokurori i shtetit i ka ofruar pasi që te pandehurit e kanë pranuar fajësinë për te dëshmuar te kaluarën penale te pandehurve, dhe nuk janë prova për te vërtetuar vajësin apo pafajësinë e të pandehurve lidhur me veprën penale për te cilën akuzohen.

Kryetari i trupit gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurve është bërë konform dispozitave të nenit 246 dhe 248 par 1 të KPP-së, pasi që të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: raporti i policit N. Z., i dt. 08.01.2021, raporti i policit hetues N. Z., i dt. 08.01.2021, deklarata e të dëmtuarit B. D., e dhënë në polici me dt. 08.01.2021 dhe në prokurori me dt. 22.02.2021, raporti mjekësor në emër të të dëmtuarit B. D., i dt. 08.01.2021, i lëshuar nga spitali i përgjithshëm në Pejë, fletë pasqyra barazimi i pompës ....., kontratë-dhënia me qira e dt. 07.01.2021, raporti i shpejtë i dt. 08.01.2021, shënimi zyrtar i dt. 08.01.2021, deklarata e dëshmitarit L. M., e dhënë në polici, me dt. 28.01.2021 dhe në prokurori me dt. 22.02.2021, deklarata e të pandehurit F. O. e dhënë në polici me dt. 09.02.2021 dhe në prokurori me dt. 02.03.2021, ekzaminimi mjekësor në emër të F. O., deklarata e të pandehurit F. R., e dhënë në polici me dt. 09.02.2021 dhe në prokurori me dt. 02.03.2021, ekzaminimi mjekësor në emër të F. R., deklarata e të pandehurit O. H., e dhënë në polici me dt. 09.02.2021 dhe në prokurori me dt. 02.03.2021, ekzaminimi mjekësor në emër të O. H., raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes i dt. 08.04.2021, foto albumi i vendit të ngjarjes i dt. 08.01.2021, foto dokumentacioni, si dhe shkresat tjera të lëndës, pastaj aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabim faktik, prandaj gjykata konform nenit 248 par 4 të KPP-së, ka pranuar pranimin e fajësisë nga të pandehurit dhe ka vazhduar me shqiptimin e dënimit ndaj te pandehurve.

Me provat e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv te aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurve F. R. dhe F. O., si bashkë kryes qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale të grabitjes, nga neni 317 par.3, lidhur me par.1 dhe nenin 31, të KPRK-së dhe të pandehurit O. H., qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprës penale nga neni 380 par.1, të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale nga ana e të pandehurve dhe të njëjtit janë penalisht përgjegjës. Sa i përket fajësisë të pandehurit, veprën e kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 par.1 të KPRK-së.

Si rrethana lehtësuese për të pandehurin, F. R. gjykata mori pranimin e fajësie për veprën e kryer dhe kërkim faljen, ndërsa rrethana rënduese ndaj te pandehurit gjykata mori faktin se i njëjti edhe me parë ka qenë i dënuar për vepra tjera penale përkatësisht, me aktgjykimin PKR. nr.10/20, te dt.09.02.2020, për vepër penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2, lidhur me

nenin 35 dhe nenin 77 të KPRK-së, po ashtu me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë P.nr. 197/18, të dt. 24.05.2018, për vepër penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim te paautorizuar te armëve nga neni 374 par.1, të KPRK-së

Për te pandehurin F. O. rrethana lehtësues gjykata mori pranimin e fajësisë për veprën e kryer, dhe kërkim faljen, ndërsa rrethana renduese ndaj te pandehurit gjykata mori faktin se i njëjti edhe me parë ka qenë i dënuar për vepra tjera penale përkatësisht, me aktgjykimin Gjykatës Komunale në Pejë P.nr.27/09, dhe P.nr.108/09, dt. 23.03.2009, ku i njëjti është dënuar për vepër penale të mashtrimit nga neni nga neni 261 par 1 lidhur me nenin 23 te KPPK-së dhe veprën penale te shpërdorimit nga neni 257 par.1, të KPPK-së, si dhe me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë P.nr. 235/10, dt. 28.03.2011, është dënuar për vepër penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim te paautorizuar te armëve nga neni 328 par.2, të KPPK-së.

Për te pandehurin O. H. rrethana lehtësues gjykata mori pranimin e fajësisë për veprën e kryer dhe kërkim faljen, ndërsa rrethana renduese ndaj te pandehurit gjykata mori faktin se i njëjti edhe me parë ka qenë i dënuar për vepra tjera penale përkatësisht me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë P.nr. 827/18, të dt. 20.07.2020, për vepër penale te lëndimit të lehtë trupor nga neni 188 par.1, nënpar.1.4, të KPRK-së.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së te pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e te pandehurve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar ne nenin 450 par. 1 dhe 2 nënpar 2.6 të KPPRK-se, gjykata për te pandehurit secilin veç e veç iu ka përcaktuar paushallin gjyqësor në shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, duke u bazuar ne shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj.

Konform nenit 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.2, të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, secilin veç e veç i obligoi në pagesën e taksës, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 463 par. 2 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarin e udhëzoi në kontest civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 365 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 370 të KPP-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA**  
**PKR.nr.62/21 dt. 15.04.2021**

**Sekretarja Juridike**  
Fitore Bojku

**Kryetari i trupit gjykues**  
Shaqë Curri

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.